

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mall

PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM

OBJEKTI I PROCEDURËS: Blerje Materiale Pastrimi

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):39830000-9

VLERA E FONDIT LIMIT: **2,913,333(dy milione e nenteqind e trembedhjete mije e treqind e tritdhjete e tre), pa TVSH.**

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”,*(i ndryshuar)* nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”*(i ndryshuar)*, autoriteti/enti kontraktor Bashkia Kukes, ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. *Sigurim oferte, sipas Shtojcës 4* **58,266.7 leke pa tvsh (pesedhjete etete mije e dyqind e gjashtedhjete e gjashte pike shtate).**

b. *Formulari përmbledhës i vetdeklarimit shtojca 9*

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP*(i ndryshuar)*., nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”*(i ndryshuar)*.

2. 1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

- Operatoret ekonomik pjesëmarrës në këtë prokurim duhet që të plotësojnë kapacitet ligjor, teknike dhe profesionale për kryerjen e këtij prokurimi.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 40, pika 5, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 ”Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”*(i ndryshuar)*.

(Shënim: *përcaktoni nëse është rasti, aktin konkret ligjor ose nënligjor që parashikon plotësimin e ndonjë kërkesë specifike për ushtrimin e veprimtarisë profesionale që lidhet me objektin e prokurimit*).

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

- a. Vërtetim nga Administrata Tatimore për xhiron mesatare vjetore për tre vitet 2023, 2024 dhe 2025, ku vlera mesatare e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar të jetë jo më e vogël se 40 % të vlerës së parashikuar të kontratës së përlogaritur.

Rekomandimi Nr. 1797/1 Prot., dt. 10.03.2022 "Rekomandim mbi hartimin e kriterëve për kualifikim për procedurat e prokurimit për mallra, pune, shërbime (i ndryshuar) me rekomandimin nr.5168 prot, dt.18.07.2024.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik"(i ndryshuar).

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Nisur nga vlera e xhiros vjetore që deklarohet nga subjekt ekonomik, varet kapaciteti financiar i tij i cili përkthehet në kapacitet për të realizuar kontratën objekt prokurimi.

Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e xhiros që mund të kërkohej, autoritetet/entitet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të xhiros brenda këtij marzhi.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar Ligji Nr.9920, datë 19.5.2008 për procedurat tatimore në republikën e Shqipërisë i ndryshuar.

(Shënim: citoni dispozitën përkatëse të legjislacionit tatimor, ku përcaktohen afatet për paraqitjen nga tatimpaguesit të deklaratës vjetore pranë organeve tatimore).

Neni 29, Cdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrisë të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës.

b. Kopje e vërtetuar të bilanceve të tre viteve të fundit (2023, 2024 dhe 2025 të paraqitur pranë Administratës Tatimore të konfirmuar nga ky autoritet, *ku të paktën në dy bilance, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit*". Kjo kërkesë konsiderohet e përmbushur nëse në dy bilance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit, të shoqëruara me Akt Ekspertizës së Ekspertit Kontabel të Autorizuar, vetëm në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve të VKM nr.285, datë 19.05.2021, neni 43, pika 4 (*shëno bazën ligjore*), ku bilancet e dy viteve të njëpasnjëshme, nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

(Shënim: ky kriter vendoset vetëm në rastet kur vlerësohet nga autoriteti/enti kontraktor)

Rekomandimi Nr. 1797/1 Prot., dt. 10.03.2022 "Rekomandim mbi hartimin e kriterëve për kualifikim për procedurat e prokurimit për mallra, pune, shërbime.(i ndryshuar) me rekomandimin nr.5168 prot, dt.18.07.2024.

Argumentimi:Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP(i ndryshuar), si dhe nenin 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik"(i ndryshuar).

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, ligji nr.25/2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare"

(Shënim: citoni dispozitën përkatëse të legjislacionit tatimor, ku përcaktohen rastet kur personat juridikë kanë detyrimin që të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, përpara publikimit të tyre, nga ekspertët kontabël ose shoqëritë audituese).

c. Vërtetim për shlyerjen e taksave vendore për vitin e fundit nga organet e qeverisjes vendore për pikat ku ushtrohet aktiviteti sipas Ekstraktit të Regjistrimit Tregtar.

* Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomik, cdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Bashkia.

Per plotesimin e kriterit te mesiperm te pikes 2.2 eshte e mjaftueshme paraqitja e deklarates, sipas shtojcës nr.9 (Formulari permbledhes i vetedeklarimit)

Argumentimi:Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, në nenin 43, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”,ndryshuar me VKM nr. 498,datë 1.8.2024; në ligjin nr.9920 date 19.05.2008 “Për procedurat tatimore” i ndryshuar, neni 4, pika 2, gërma d) dhe në Ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar. R eferuar sa më sipër, Autoriteti Kontraktor gjykon se kriteri i vendosur lidhur me dorëzimin nga ana e operatorëve ekonomikë të deklaratës për shlyerjen e detyrimeve vendore për vitin 2024 sipas kësteve pranë bashkisë/ve ku operatori ekonomik ushtron aktivitetin e tij është në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi e konkretisht me Ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 për “Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar. Të gjithë subjektet që ushtrojnë veprimtari biznesi kanë detyrimin ligjor të regjistrimit pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit për të bërë të identifikueshëm vendodhjen e aktivitetit të tyre dhe për t’iu nënshtuar pagesës së taksave vendore të parashikuara shprehimisht në këtë ligj.

Rekomandimi Nr. 1797/1 Prot., dt. 10.03.2022 ”Rekomandim mbi hartimin e kriterëve për kualifikim për procedurat e prokurimit për mallra, pune, shërbime(i ndryshuar)

Kriteri konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas shtojcës 9 të DT. Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqitën referuar përcaktimeve të nenit 26, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar , përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor

2.3.Kapaciteti teknik

2.3.1 Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti kontraktor kërkon dëshmi për furnizimet e mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tri viteve të fundit. Në çdo rast, vlera e kërkuar duhet të jetë në një vlerë *jo më të vogël* se 20% të vlerës së përllëguar të kontratës, që prokurohet që është realizuar gjatë tri viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

a)Autoriteti Kontraktor si dëshmi për përvojën e mëparshme kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik, kontrata furnizimi ose/dhe fatura tatimore të shitjes,*te plotesuar sipas legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore* ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

b) Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, *te plotesuara sipas legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore* ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara. ”

Rekomandimi Nr. 1797/1 Prot., dt. 10.03.2022 ”Rekomandim mbi hartimin e kriterëve për kualifikim për procedurat e prokurimit për mallra, pune, shërbime.(i ndryshuar) me rekomandimin nr.5168 prot, dt.18.07.2024.

Argumentimi:Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”(i ndryshuar) dhe nenit 40, pika 4 (ose në rastin e procedurave të thjeshtuara në nenin 55, pika 4/b), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”(i ndryshuar). Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën,

prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë ne vlerën jo më pak se 20 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Nese operatori ekonomik ka realizuar me sukses nje kontrate e cila i pergjegjet 20% te vleres se fondit limit atehere ai ka kapacitet per te realizuar kontraten ne fjale. Percaktimi i kesaj vlere eshte bere ne perputhje me aktet ligjore dhe nenligjor.

Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e kontratave të ngjashme që mund të kërkohej, autoritete/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të kontratave të ngjashme brenda këtij marzhi.

2.3.2 Ne funksion të zbatimit të kontrates, kerkohet te jene ne dispozicion keto mjete pune:

Nr.	Emertimi	Njesia	Sasia	Gjendja Juridike
1.	Automjet per transportimin e materialeve te pastrimit	Cope	1	Pronësi ose me qera

a). Per te deshmuar kete, operatoret ekonomik duhet te paraqesin dokumentat e meposhtem:

- Per mjetet qe shenohen ne regjistra publike, nese jane ne pronesi, duhet te paraqiten dokumentat qe vertetojne regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi), çertifikaten e kontrollit teknik, policen e sigurimit vjetor te vlefshme pergjate zbatimit te kontrates.
- Per mjetet qe shenohen ne regjistrat publik, nese jane me qera, duhet te paraqiten dokumentacioni qe verteton pronesine e mjetit, kontrata noteriale e qerese e vlefshme per te gjithë periudhen e realizimit te kontrates objekt prokurimi, regjistrimi i mjetit (leja e qarkullimit), çertifikata e kontrollit teknik, polica e sigurimit vjetor.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 5/ç, të VKM nr.

285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohej që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën. Mjeti i transportit kerkohet per te garantuar zbatimin ne kontrates dhe transportimin e mallit te prokuruar deri ne destinacionin e percaktuar nga AK.

2.3.3 Operatori ekonomik duhet te deklaroje ne formularin permbledhes te vetdeklarimit se do dorezojë m allin objekt prokurimi ne vendin e kerkuar sipas kërkesave së Autoritetit Kontraktor, formularit te sasive d he afatit të lëvrimit.

Per plotesimin e kriterit te mesiperm te pikes eshte e mjaftueshme paraqitja e deklarates, sipas shtojcës nr.9 (Formulari permbledhes i vetedeklarimit). Operatori ekonomik qe do te shpallet fitues, para lidhjes se kontrates, duhet te dorezoje vertetimin e mesiperm.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 40, pika 8 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”(i ndryshuar). Kjo kerkese shikohet e arsyeshme per te provuar gatishmerine e operatorit qe gjate 12 muajve te afatit te zbatimit kontrates te jete i gatshem ta furnizojë AK ne momentin qe ketij te fundit i nevojiten mallrat objekt prokurimi dhe gjithashtu per ta garantuar AK se operatori fitues realizon transportin deri ne destinacion.

Ne lidhje me momentin e paraqitjes se dokumentacionit deshmues per kerkesat qe perfshihen ne formularin permbledhes te vetedeklarimit, mbajme ne konsiderate percaktimet e nenit 26, pika 6, te VKM 285, DT.19.05.2021, i ndryshuar , ku parashikohet qe “Perpara publikimit te njoftimit te fituesit dhe nisjes se afateve te ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kerkon ofertuesit te kualifikuar i pari dorezimin e dokumenteve provuese te parashikuara ne shkronjar “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j”, te pikes 2 te ketij neni , si dhe dokumentet e tjera shoqeruese te ofertes, te dorezuara ne rruge elektronike. Keto dokumente duhet te paraqiten ne original ose ne kopje te njehsuara me origjinalin.

Rekomandimi Nr. 1797/1 Prot., dt. 10.03.2022 ”Rekomandim mbi hartimin e kriterëve për kualifikim për procedurat e prokurimit për mallra, pune, shërbime.(i ndryshuar) me rekomandimin nr.5168 prot, dt.18.07.2024.

Argumentim: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”(i ndryshuar) dhe nenit 40, pika 5/ç, të VKMnr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”,(i ndryshuar) me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion mjetet dhe pajisjet teknike për të përmbushur kontratën, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit.

2.3.6 Operatori ekonomik ofertues duhet të jetë i pajisur dhe të paraqesë certifikatë të lëshuar nga organizmat e vlerësimit të konformitetit, të akredituara nga organizmi kombëtar akreditues, ose organizma ndërkombëtare akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, në përputhje me objektin e prokurimit, si më poshtë:

- ISO 9001:2015 “Mbi sistemet e menaxhimit të cilësisë” (e vlefshme) ose ekuivalent;

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Në bazë të nenit të 36, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” nenit 15, pika 3/b dhe nenit 40, pika 2 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar). Specifikimet teknike, për mallrat objekt prokurimi, përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara si dhe janë në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar). Specifikimet teknike sipas DST janë hartuar nga grupet e punës të ngritura nga Titullarët e Autoriteteve Kontraktore përfituese, në përputhje me ligjin nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar si dhe VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Shënim: Për çdo certifikatë, standart, markë, emër i veçantë, patentë, vizatim ose tip, origjinë specifike, prodhues ose sipërmarrës të përmendur më lart, pranohet edhe ekuivalenti i tyre.